



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



Adresa: Rr 13 Dhjetori, Nr 1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al

e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

V E N D I M

Nr. 66, datë 30.12.2016

Për një ndryshim në VKB nr. 59, datë 17.6.2015, për vlersimin paraprak dhe masën e shpërblimit për shpronësimin e pronës private, për interes publik

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016, mbështetur në nenin 9 pika 1.2 shkronja "b", nenin 23 pika 4, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", të ndryshuar, VKM nr. 127, datë 23.3.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", shkresës kthim përgjigje nr. 3068/1 prot, datë 27.5.2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me propozim të kryetarit të bashkisë,

V E N D O S I :

1. Në VKB nr. 59, datë 17.6.2015 të miratojë ndryshimin e vlersimit paraprak dhe masës së shpërblimit për shpronësimin e pronës private (truall+ndërtesë) për investim publik për objektin "sistemim blloqe banimi Zogu I, krahu i djathtë (zyra e punës, drejtoria e bujqësisë)" në vlerën **411,590 lekë** (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) dhe pasqyrën bashkëngjitur.
2. Fondi i shpronësimit prej 411,590 lekë është parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.12.2016

Shpallur në datën 4.1.2017

Sekretar i keshillit

Suel Hadri



KRYETARI

Xhemal BUSHATI